ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E SKENDERAJT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**643-26-9247-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"010 – Hartimi i projekteve teknike në Komunën e Skenderajt – Ritender"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

A & E GROUP SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Shefqet Shkupi", nr. 25
(Adresa)

Prishtinë — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 45 689 135 — N/A
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Edvis Spahiu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Aegroup.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)



23.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës) — (Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë
(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) _____ *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 26.10.2026 Hapja e planifikuar e ofertave: 25.11.2026 Kërkesë për rishqyrtim: 10.11.2026 Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit: 10.11.2026 Vendimit të Autoritetit Kontraktues: 13.11.2026 Njoftimi për Korrigjimin e Gabimeve: 16.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I. GJENDJA FAKTIKE DHE BAZA JURIDIKE

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet është publikuar me datë 23.10.2026, ndërsa afati fillestar i hapjes së ofertave ishte data 16.11.2026. Ankuesi me datë 10.11.2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me elaborim të veçantë të certifikimeve të kërkuara për personelin, specifikimeve të pajisjeve dhe kufizimit të formave të dëshmimit të disponueshmërisë së tyre. Po atë ditë, Autoriteti Kontraktues ka marrë Vendimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit, duke i'u referuar shprehimisht kësaj kërkese. Me datë 13.11.2026, Autoriteti kontratues ka nxjerrë vendim me të cilin ka aprovuar kërkesën vetëm pjesërisht, duke deklaruar se pretendimet nr. 1, 2 dhe 6 do të adresoheshin përmes formularit B54, ndërsa pretendimet nr. 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10 dhe 11 i ka konsideruar si të pabazuara.

Vërejmë se arsyetimi i refuzimit, i përmbledhur në pohimin se kërkesat "janë rezultat i analizimit të nevojave reale të projektit dhe konsiderohen të domosdoshme për realizimin e tij", nuk përmban analizë të individualizuar për asnjërin nga tetë pretendimet e refuzuara. Me gjithë respektin në raport të diskrecionit të Autoritetit Kontraktues për të përcaktuar kërkesat e shërbimeve që synon të sigurojë, konsiderojmë se ky diskrecion nuk është i pakufizuar por si i tillë ushtrohet brenda kërkesave të ligjshmërisë, relevancës, qartësisë dhe proporcionalitetit. Për këtë arsye, përsëritja e pretendimit se kriteret janë të nevojshme nuk është e barasvlershme me paraqitjen e arsyeve faktike e teknike përse secili kriter, në formën konkrete siç është shkruar, duhet të mbetet kusht eliminues. Andaj, pikërisht ky dallim ndërmjet konstatimit dhe arsyetimit është thelbësor për kontrollin efektiv të ligjshmërisë nga OSHP-ja.

Neni 7, paragrafi 1, i LPP-së përcakton:

"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."

Neni 7, paragrafi 2, i LPP-së përcakton:

"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik."

Neni 51, paragrafi 3, i LPP-së përcakton:

"Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse."

Neni 69, paragrafi 1, i LPP-së, ndër të tjera, përcakton:

"Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen."

Neni 28, paragrafi 2, i LPP-së përcakton:

"Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit."

Neni 28, paragrafi 7, i LPP-së, ndër të tjera, përcakton:

"Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi."

Krahas kësaj, neni 51, paragrafi 1, i LPP-së përcakton se:

"Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar".

Nga analizimi i të gjitha këtyre rregullave rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk mjafton të konstatojë se një kërkesë është e dobishme por duhet të tregojë se ajo është relevante, e nevojshme dhe proporcionale. Mbi bazën e kësaj, Ankuesi nuk kërkon heqjen e standardeve të kualitetit, por zëvendësimin e kërkesave të papërcaktuara ose të mbingarkuara me kritere të qarta, objektive dhe funksionalisht të barasvlershme.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

II. PRETENDIMET ANKIMORE

Në vijim, Operatori Ekonomik A&E Group SH.P.K. paraqet dhe elaboron pretendimet ankimore lidhur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Skenderajt, të datës 13.11.2026, përmes të cilit janë refuzuar pretendimet nr. 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të kërkesës për rishqyrtim. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar pretendimet e lartcekura pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm faktik, teknik dhe juridik, duke u mbështetur në konstatime të përgjithshme mbi domosdoshmërinë e kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit, pa vlerësuar individualisht bazueshmërinë e secilit kundërshtim. Për rrjedhojë, në vijim kundërshtohen dhe elaborohen në mënyrë të veçantë këto pretendime, duke u mbështetur në përmbajtjen e kërkesës fillestare për rishqyrtim, dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë si dhe konkurrencës së lirë.

PRETENDIMI 1 – <u>Refuzimi i pretendimit nr. 3: Kërkesa për certifikim në Menaxhimin e Aseteve të Sistemit Elektroenergjetik</u>

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të kundërshtuar, ka refuzuar pretendimin e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesën që inxhinieri i diplomuar ose master i Elektroteknikës, drejtimi Energjetik, të posedojë certifikim në Menaxhimin e Aseteve të Sistemit Elektroenergjetik, pa ofruar arsyetim konkret mbi domosdoshmërinë e këtij certifikimi në raport me natyrën dhe objektin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se menaxhimi i aseteve elektroenergjetike përfshin kryesisht administrimin, operimin, vlerësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës energjetike, ndërsa aktiviteti përkatës i prokurimit ka për objekt hartimin e projekteve teknike në Komunën e Skenderajt. Ndonëse këto fusha mund të ndërlidhen në rrethana të caktuara, një ndërlidhje e tillë nuk mund të prezumohet pa identifikuar detyrat konkrete që kërkojnë këtë specializim. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të arsyetojë se cilat aktivitete specifike të projektimit kërkojnë domosdoshmërisht posedimin e këtij certifikimi dhe përse kualifikimi akademik, përvoja profesionale apo kompetencat e tjera të dokumentuara nuk konsiderohen të mjaftueshme për përmbushjen e tyre.

Për më tepër, kërkesa e kontestuar nuk përcakton qartë programin, nivelin apo institucionin kompetent për lëshimin e certifikimit, e as mundësinë e pranimit të certifikimeve ose dëshmive profesionale ekuivalente. Një formulim i tillë krijon pasiguri për operatorët ekonomikë lidhur me mënyrën e përmbushjes së kriterit dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave. Në këto rrethana, refuzimi i pretendimit vetëm mbi bazën e konstatimit të përgjithshëm se kriteri buron nga nevojat reale të projektit nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm për të justifikuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tij. Prandaj, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të dëshmojë lidhjen objektive ndërmjet certifikimit të kërkuar dhe shërbimeve konkrete që do të realizohen, duke vendosur një kusht potencialisht kufizues për konkurrencën. Për këto arsye, *<u>kërkojmë që ky pretendim ankimor të aprovohet dhe kriteri përkatës të rishikohet, duke mundësuar dëshmimin e kompetencave profesionale edhe përmes kualifikimeve, përvojës dhe certifikimeve ekuivalente, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.</u>*

PRETENDIMI 2 – Refuzimi i pretendimit nr. 4: Kërkesa për certifikimet Autodesk Civil dhe GIS për inxhinierin e gjeodezisë

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të kundërshtuar, po ashtu ka refuzuar edhe pretendimin e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesën që inxhinieri i gjeodezisë, përveç kualifikimit akademik dhe licencimit profesional, të posedojë edhe certifikimet Autodesk Civil dhe GIS, pa

ofruar arsyetim të mjaftueshëm mbi domosdoshmërinë e tyre për realizimin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se Autodesk Civil i referohet një zgjidhjeje të caktuar softuerike, ndërsa GIS përfaqëson një fushë më të gjerë teknologjike që përfshin mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe paraqitjen e të dhënave hapësinore. Për rrjedhojë, trajtimi i këtyre dy koncepteve si certifikime të një natyre të njëjtë pa përcaktuar standardin, nivelin e kompetencës apo institucionin certifikues, krijon paqartësi lidhur me mënyrën e përmbushjes së kriterit dhe mund të rezultojë në vlerësim jo të njëtrajtshëm të operatorëve ekonomikë. Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të sqarojë se cilat detyra konkrete të projektimit kërkojnë domosdoshmërisht posedimin e këtyre certifikimeve dhe pse kompetencat përkatëse nuk mund të dëshmohen përmes përvojës profesionale apo njohurive të dokumentuara në përdorimin e programeve ekuivalente.

Për më tepër, aktivitetet që synohen të realizohen përmes këtyre programeve, përfshirë përpunimin e të dhënave gjeodezike, modelimin e terrenit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik mund të përmbushen edhe përmes zgjidhjeve të tjera softuerike që ofrojnë funksionalitete dhe rezultate të barasvlershme. Nëse Autoriteti Kontraktues ka nevoja të veçanta për ndërveprueshmëri me sistemet ekzistuese, këto duhet të përcaktohen përmes parametrave objektivë dhe standardeve të dorëzimit, e jo domosdoshmërisht përmes certifikimeve të lidhura me produkte të caktuara. Kështu, në mungesë të një arsyetimi konkret mbi nevojën për kufizimin e dëshmimit të kompetencave vetëm përmes certifikimeve të kërkuara, refuzimi i pretendimit rezulton i pamjaftueshëm dhe potencialisht në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë si dhe me kërkesat për specifikime teknike jodiskriminuese dhe pranimin e zgjidhjeve ekuivalente sipas nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik. *Prandaj, kërkojmë që ky pretendim ankimor të aprovohet dhe kriteri përkatës të rishikohet, duke mundësuar dëshmimin e kompetencave profesionale edhe përmes përvojës së dokumentuar, certifikimeve të krahasueshme dhe zgjidhjeve teknologjike ekuivalente.*

PRETENDIMI 3 – Refuzimi i pretendimit nr. 5: Kërkesa për personin e certifikuar në Autodesk Civil dhe Plateia

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të kundërshtuar, ndër të tjera ka refuzuar edhe pretendimin e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesën për angazhimin e një personi të certifikuar në Autodesk Civil dhe Plateia, pa ofruar arsyetim konkret mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e këtij kriteri në raport me objektin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar qartë profilin profesional, kualifikimin akademik, përvojën minimale apo përgjegjësitë konkrete që duhet t'i përmbushë ky person gjatë realizimit të projektit. Gjithashtu, nuk është sqaruar nëse kërkohen dy certifikime të veçanta apo një certifikim i kombinuar, cili është niveli i kompetencës së kërkuar dhe cilat institucione janë kompetente për lëshimin e tyre. Andaj, konsiderojmë se këto paqartësi nuk përbëjnë thjeshtë mangësi formale, por ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e operatorëve ekonomikë për të identifikuar personelin e përshtatshëm dhe për të përgatitur oferta konkurruese në kushte të barabarta.

Për më tepër, kërkesa për certifikimin Autodesk Civil është përcaktuar edhe për inxhinierin e gjeodezisë, duke krijuar mbivendosje të kërkesave profesionale, pa u arsyetuar nevoja për angazhimin e dy personave me kompetenca të ngjashme. Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar nëse këta profesionistë do të kryejnë detyra të ndryshme që kërkojnë angazhim të njëkohshëm, apo nëse nevojat e projektit mund të përmbushen nga një profesionist që posedon kompetencat përkatëse. Rrjedhimisht, në mungesë të një arsyetimi të tillë, konstatimi i përgjithshëm se kriteri është i domosdoshëm për realizimin e kontratës nuk mjafton për të justifikuar kufizimin e konkurrencës. Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të dëshmojë lidhjen objektive dhe proporcionale ndërmjet kërkesës së kontestuar dhe nevojave konkrete të projektit, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 7 dhe 51 të Ligjit për Prokurimin Publik. *Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe riformulimin e kriterit,*

duke përcaktuar qartë funksionin profesional, përgjegjësitë dhe kompetencat e nevojshme si dhe duke lejuar dëshmimin e tyre përmes kualifikimeve, përvojës dhe certifikimeve ekuivalente.

PRETENDIMI 4 – Refuzimi i pretendimit nr. 7: Kërkesa për certifikim në Menaxhimin e Projekteve Publike

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të kundërshtuar, ka refuzuar edhe pretendimin e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesën që inxhinieri i drejtimit Hidroteknikë të posedojë certifikim në Menaxhimin e Projekteve Publike, pa ofruar arsyetim konkret mbi domosdoshmërinë dhe relevancën e këtij certifikimi për realizimin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar qartë standardin profesional, përmbajtjen e programit, nivelin e kualifikimit apo institucionin kompetent për lëshimin e certifikimit, duke krijuar pasiguri lidhur me dokumentacionin që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për përmbushjen e këtij kriteri. Për më tepër, nuk është sqaruar përse një certifikim i tillë kërkohet në mënyrë specifike për inxhinierin e hidroteknikës, pa identifikuar përgjegjësitë konkrete menaxheriale që ky profesionist do të ushtrojë gjatë realizimit të kontratës. Në mungesë të këtyre përcaktimeve, kriteri mbetet i paqartë dhe krijon mundësi për interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Theksojmë se ndonëse kompetencat në menaxhimin e projekteve mund të jenë të rëndësishme për realizimin e suksesshëm të kontratës, ato nuk dëshmohen domosdoshmërisht vetëm përmes një certifikimi të emërtuar, por mund të vërtetohen edhe përmes përvojës profesionale, referencave, projekteve të menaxhuara dhe kualifikimeve të tjera ekuivalente. Kështu, në vend që të arsyetojë përse këto forma të dëshmimit nuk janë të mjaftueshme, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se kriteri është i domosdoshëm për realizimin e projektit, pa demonstruar lidhjen objektive ndërmjet certifikimit të kërkuar dhe detyrave konkrete të kontratës. Për rrjedhojë, konsiderojmë se refuzimi i pretendimit nuk është mbështetur në një vlerësim të mirëfilltë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të kriterit, në përputhje me kërkesat e nenit 51 të Ligjit për Prokurimin Publik. Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe rishikimin e kriterit përkatës, duke përcaktuar qartë kompetencat menaxheriale të nevojshme dhe duke lejuar dëshmimin e tyre përmes përvojës së dokumentuar, trajnimeve dhe certifikimeve ekuivalente.

PRETENDIMI 5 – Refuzimi i pretendimit nr. 8: Kërkesa për certifikim FIDIC për inxhinierin e infrastrukturës rrugore

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që inxhinieri i infrastrukturës rrugore, përveç kualifikimit akademik dhe përvojës profesionale pesëvjeçare, të posedojë edhe certifikim FIDIC, konsiderojmë se është e paarsyetuar dhe joproporcionale në raport me natyrën dhe objektin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se standardet FIDIC lidhen kryesisht me kushtet kontraktuale, administrimin dhe menaxhimin e kontratave të ndërtimit, përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit, administrimin e ndryshimeve dhe trajtimin e pretendimeve kontraktuale, ndërsa aktiviteti përkatës i prokurimit ka për objekt hartimin e projekteve teknike. Ndonëse njohuritë mbi kushtet FIDIC mund të jenë të dobishme në rrethana të caktuara, ato nuk përbëjnë domosdoshmërisht kualifikim profesional të nevojshëm për ushtrimin e detyrave të projektimit të infrastrukturës rrugore. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar kushtet konkrete FIDIC që do të zbatohen, llojin apo nivelin e certifikimit të kërkuar dhe, mbi të gjitha, përgjegjësitë specifike të inxhinierit që do ta bënin të domosdoshëm posedimin e këtij certifikimi. Në mungesë të këtyre përcaktimeve, vendosja e certifikimit FIDIC si kriter i detyrueshëm për kualifikim krijon kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë, pa u dëshmuar lidhja e drejtpërdrejtë e tij me shërbimet që do të realizohen.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar përse kompetencat e kërkuara nuk mund të dëshmohen përmes përvojës profesionale në realizimin dhe administrimin e kontratave të ngjashme apo të sigurohen përmes angazhimit të personelit të specializuar për administrimin kontraktual. Në vend të një vlerësimi konkret të këtyre mundësive, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se kriteri është i domosdoshëm për realizimin e projektit, pa shpjeguar përse format e tjera të dëshmimit të kompetencave nuk do të garantonin të njëjtin rezultat. Për rrjedhojë, konsiderojmë se refuzimi i këtij pretendimi nuk është mbështetur në një arsyetim të mjaftueshëm faktik dhe teknik, ndërsa kriteri i kontestuar nuk është justifikuar në raport me parimin e proporcionalitetit dhe kërkesat e nenit 51 të Ligjit të Prokurimit Publik. *Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe rishikimin e kriterit përkatës, duke përcaktuar qartë kompetencat që kërkohen për realizimin e kontratës dhe duke mundësuar dëshmimin e tyre përmes përvojës së dokumentuar, kualifikimeve profesionale dhe certifikimeve ekuivalente.*

PRETENDIMI 6 – Refuzimi i pretendimit nr. 9: Kërkesa për certifikim për Mbrojtje nga Zjarri nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME)

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që inxhinieri i drejtimit Hidroteknikë të posedojë certifikim për Mbrojtje nga Zjarri, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME), konsiderojmë se është e paarsyetuar dhe joproporcionale në raport me natyrën dhe objektin e kontratës. Në këtë drejtim, ndonëse mbrojtja nga zjarri përbën një aspekt të rëndësishëm të sigurisë së objekteve dhe infrastrukturës, kjo nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të përcaktuar kritere të qarta, objektive dhe të ndërlidhura drejtpërdrejt me shërbimet që do të realizohen. Përkatësisht, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar cilat sisteme apo projekte konkrete të mbrojtjes nga zjarri kërkojnë këtë certifikim, përse kompetencat përkatëse duhet t'i atribuohen domosdoshmërisht një inxhinieri të hidroteknikës dhe mbi cilën bazë ligjore apo teknike mbështetet një kombinim i tillë i kualifikimit akademik me certifikimin e kërkuar. Në mungesë të një arsyetimi të tillë, kriteri i kontestuar krijon kufizime potencialisht të pajustifikuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, pa u dëshmuar domosdoshmëria e tij për realizimin e kontratës.

Për më tepër, nëse certifikimi apo autorizimi përkatës nga AME përbën kusht të detyrueshëm ligjor për kryerjen e shërbimeve të caktuara, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të identifikojë dispozitën përkatëse ligjore, kategorinë dhe fushëveprimin e autorizimit, si dhe profilet profesionale që kanë të drejtë ta posedojnë atë. Në të kundërtën, nëse legjislacioni nuk e kufizon ushtrimin e këtyre detyrave vetëm te profesionistët e drejtimit Hidroteknikë, kriteri duhet të mundësojë angazhimin edhe të profesionistëve të tjerë që përmbushin kërkesat ligjore dhe teknike përkatëse. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar një analizë të tillë, duke u kufizuar në konstatimin e përgjithshëm mbi domosdoshmërinë e kriterit. Për rrjedhojë, konsiderojmë se refuzimi i këtij pretendimi nuk është mbështetur në një arsyetim të mjaftueshëm faktik, teknik dhe juridik, ndërsa kriteri i kontestuar nuk është justifikuar në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, të përcaktuara në nenet 7 dhe 51 të Ligjit për Prokurimin Publik. *Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe rishikimin e kriterit, duke përcaktuar qartë autorizimet e nevojshme dhe duke mundësuar angazhimin e të gjithë profesionistëve që përmbushin kushtet ligjore dhe profesionale për realizimin e shërbimeve përkatëse.*

PRETENDIMI 7 – Refuzimi i pretendimit nr. 10: Specifikimet teknike të pajisjeve të përcaktuara në Aneksin 7

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues lidhur me pajisjet teknike të përcaktuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit konsiderojmë se janë të paarsyetuara dhe joproporcionale në raport me

natyrën dhe objektin e kontratës, pasi disa prej tyre përmbajnë specifikime tepër të ngushta dhe konfigurime të caktuara teknologjike, ndërsa për pajisje të tjera mungojnë parametrat objektivë që do të mundësonin vlerësimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Në këtë drejtim, duhet theksuar se Operatori Ekonomik nuk e kundërshton domosdoshmërinë e posedimit apo sigurimit të kapaciteteve të nevojshme teknike për realizimin e kontratës, por mënyrën se si Autoriteti Kontraktues i ka përcaktuar këto kërkesa, pa dëshmuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet specifikimeve të vendosura dhe rezultateve konkrete që synohen të arrihen. Për rrjedhojë, përcaktimi i pajisjeve përmes emërtimeve të veçanta teknologjike, në vend të parametrave funksionalë dhe të matshëm, mund të kufizojë në mënyrë të pajustifikuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë pajisje me performancë të njëjtë apo më të avancuar.

Konkretisht, kërkesa për dronin me konfigurim "LiDAR L3" dhe "D-RTK 3 Relay Fixed Deployment System", si dhe për skanerin Handheld SLAM me kamerë 2×16 MP, nuk është shoqëruar me arsyetim mbi domosdoshmërinë e këtyre konfigurimeve në raport me saktësinë e matjeve, kapacitetin e skanimit, gjeoreferencimin dhe cilësinë e të dhënave që kërkohen për realizimin e projektit. Po kështu, për pajisjet GPS dhe Total Station Robotic nuk janë përcaktuar mjaftueshëm parametrat teknikë minimalë, standardet përkatëse të kalibrimit dhe arsyet që justifikojnë numrin e instrumenteve të kërkuara. Ndërkaq, kërkesa për dy automjete me pesë dyer nuk është ndërlidhur me nevojat konkrete të transportit dhe karakteristikat funksionale të domosdoshme për qasje në terren. Veçanërisht problematike mbeten edhe specifikimet për pajisjet kompjuterike, përkatësisht laptopin me 64 GB RAM, 24 GB GPU dhe 2 TB SSD, si dhe workstation me 256 GB RAM, 24 GB GPU dhe 1 TB SSD, për të cilat Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar programet, proceset apo ngarkesat konkrete të përpunimit që do të arsyetonin kapacitete të tilla. Madje, përdorimi i njëkohshëm i termave "PC" dhe "laptop" krijon paqartësi shtesë lidhur me kategorinë e pajisjes së kërkuar.

Pavarësisht këtyre kundërshtimeve konkrete, Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të kundërshtuar, nuk ka ofruar analizë të individualizuar mbi domosdoshmërinë e specifikimeve për secilën pajisje, duke u kufizuar në konstatime të përgjithshme lidhur me nevojat e projektit. Një arsyetim i tillë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar vendosjen e kritereve që mund të pengojnë konkurrencën, veçanërisht kur rezultatet e kërkuara mund të sigurohen edhe përmes pajisjeve dhe konfigurimeve teknologjike ekuivalente. Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e specifikimeve të kontestuara, në përputhje me kërkesat e neneve 7, 28 dhe 51 të LPP-së, të cilat synojnë garantimin e trajtimit të barabartë, konkurrencës efektive dhe përcaktimin e kritereve objektive në raport me nevojat e kontratës. *Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe rishikimin e Aneksit 7, duke përcaktuar parametra teknikë dhe funksionalë të qartë, të matshëm dhe proporcionalë si dhe duke mundësuar pranimin e pajisjeve dhe zgjidhjeve teknologjike ekuivalente që garantojnë realizimin e suksesshëm të kontratës.*

PRETENDIMI 8 – Refuzimi i pretendimit nr. 11: Kërkesa për dëshmimin e pajisjeve përmes faturës tatimore dhe transferit bankar

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që disponueshmëria e pajisjeve teknike të dëshmohet vetëm përmes faturës tatimore dhe transferit bankar konsiderojmë se është e paarsyetuar dhe joproporcionale, pasi kufizon në mënyrë të panevojshme format e ligjshme përmes të cilave operatorët ekonomikë mund të sigurojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se posedimi i kapaciteteve teknike nuk mund të barazohet domosdoshmërisht me pronësinë e drejtpërdrejtë mbi pajisjet, përderisa operatorët ekonomikë mund t'i sigurojnë ato edhe përmes kontratave të qirasë, marrëveshjeve të leasing-ut, marrëveshjeve për vënien në dispozicion apo formave të tjera të ligjshme të angazhimit të kapaciteteve. Një qasje e tillë mbështetet edhe në nenin 69, paragrafi 4.5, të *Ligjit për Prokurimin Publik*, i cili si dëshmi të kapacitetit teknik parasheh "raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e

shërbimeve". Për rrjedhojë, rëndësi juridike ka disponueshmëria reale dhe e dëshmueshme e pajisjeve gjatë realizimit të kontratës, e jo domosdoshmërisht mënyra e fitimit të pronësisë mbi to.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues, në vendimin e datës 13.11.2026, ka pranuar se pajisjet mund të sigurohen edhe përmes marrëveshjeve të ligjshme me operatorë ekonomikë apo furnizues të tjerë, duke konfirmuar kështu bazueshmërinë e kundërshtimit të paraqitur nga Ankuesi. Megjithatë, një konstatim i tillë në arsyetimin e vendimit nuk është i mjaftueshëm për të eliminuar kufizimin e vendosur në dosjen e tenderit, nëse ndryshimet përkatëse nuk pasqyrohen shprehimisht në dokumentacionin detyrues të prokurimit. Për këtë arsye, është e domosdoshme që Autoriteti Kontraktues, përmes formularit B54 dhe dosjes së korrigjuar të tenderit, të përcaktojë qartë të gjitha format e pranueshme të dëshmimit të disponueshmërisë së pajisjeve, duke shmangur çdo kundërthënie ndërmjet vendimit të nxjerrë dhe kritereve mbi bazën e të cilave do të vlerësohen ofertat.

Përveç kësaj, duhet theksuar se kriteret e kundërshtuara në kuadër të kësaj ankese nuk mund të vlerësohen vetëm në mënyrë të izoluar, por edhe në raport me efektin e tyre të përbashkët mbi konkurrencën. Kërkesat për certifikime të specializuara, përdorimin e programeve të caktuara softuerike, konfigurime specifike të pajisjeve dhe dëshmimin e tyre vetëm përmes dokumenteve të pronësisë mund të krijojnë pengesa të pajustifikuara për operatorët ekonomikë që, ndonëse disponojnë kapacitetet e nevojshme profesionale dhe teknike, nuk i përmbushin këto kushte formale. Në këtë drejtim, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të vlerësojë jo vetëm domosdoshmërinë e secilit kriter veçmas, por edhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në konkurrencë, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 7, 51 dhe 69 të LPP-së. Mirëpo, një vlerësim i tillë mungon në vendimin e kundërshtuar.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar mjaftueshëm kufizimin e formave të dëshmimit të kapaciteteve teknike dhe nuk ka siguruar përputhshmëri të qartë ndërmjet vendimit për rishqyrtim dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Prandaj, kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi ankimor dhe detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të harmonizojë dokumentacionin e tenderit me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik duke lejuar dëshmimin e disponueshmërisë së pajisjeve përmes të gjitha formave të ligjshme, me kusht që të garantohet përdorimi i tyre gjatë realizimit të kontratës. Njëkohësisht, kërkojmë që OSHP të shqyrtojë formularin B54 dhe dosjen e korrigjuar të tenderit, me qëllim të verifikimit nëse ndryshimet e paralajmëruara nga Autoriteti Kontraktues janë zbatuar realisht dhe në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Duke u mbështetur në faktet dhe arsyetimin e paraqitur më sipër, propozojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas administrimit të shkresave të aktivitetit të prokurimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të kësaj ankese, të nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik A&E GROUP SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "010 – Hartimi i projekteve teknike në Komunën e Skenderajt – Ritender", me numër të prokurimit 643-26-9247-2-1-1.

ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Skenderajt, i datës 13.11.2026, në pjesën me të cilën janë refuzuar pretendimet nr. 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik A&E GROUP SH.P.K., të datës 10.11.2026.

DETYROHET Autoriteti Kontraktues – Komuna e Skenderajt, që aktivitetin e prokurimit "010 – Hartimi i projekteve teknike në Komunën e Skenderajt – Ritender",

me numër të prokurimit 643-26-9247-2-1-1, t'a kthejë në RISHQYRTIM DHE KORRIGJIM TË DOSJES SË TENDERIT, duke i eliminuar ose ndryshuar kriteret dhe kërkesat e kundërshtuara, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

Prova nr. 1: *Kopja e Njoftimit për Kontratë, të datës 23.10.2026, për aktivitetin e prokurimit "010 – Hartimi i projekteve teknike në Komunën e Skenderajt – Ritender", me numër prokurimi 643-26-9247-2-1-1;*

Prova nr. 2: *Kopja e Kërkesës për Rishqyrtim, të datës 10.11.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik A&E Group SH.P.K. pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Skenderajt;*

Prova nr. 3: *Kopja e Vendimit për Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit, të datës 10.11.2026, të nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Skenderajt;*

Prova nr. 4: *Kopja e Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Skenderajt, të datës 13.11.2026, me të cilin është aprovuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik A&E Group SH.P.K.;*

Prova nr. 5: *Kopja e Dosjes së Tenderit, përfshirë Aneksin 7 – Lista e Pajisjeve, në të cilën janë përcaktuar kriteret profesionale dhe teknike të kundërshtuara;*

Prova nr. 6: *Kopja e formularit B54 – Njoftimi për Korrigjimin e Gabimeve dhe dokumentacioni i korrigjuar i tenderit, nëse janë publikuar nga Autoriteti Kontraktues;*

Prova nr. 7: *Kopja e njoftimeve dhe komunikimeve përkatëse nga platforma elektronike e prokurimit, që ndërlidhen me kërkesën për rishqyrtim dhe vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktues*